



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.882/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Glllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares të Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Agim Bregaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Agim Bregaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017,

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, në fshatrat Stanovc, Novolan, Dumnicë dhe Maxhunaj, në Vendvotimet nr 2717B/1R, 2717B/2R, 2709B/02R, 2717B/01R, 2717B/02R, 2709B/02R, 2714B/01R, 2714B/03R, 27147B/02R dhe 2707B/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin më datë 10.11.2017, nga Agim Bregaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, me të cilën pretendon se në fshatrat Stanovc, Novolan, Dumnicë dhe Maxhunaj, në Vendvotimet nr 2717B/1R, 2717/2R, 2709B, 2714B/03R-01R, 2707B/01R, duke i kërkuar PZAP-it që të bëhet rinumërimi i votave, pasi që janë bërë pa rregullsi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve në apel dhe shkresave të lëndës, në mbështetje të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet në apel janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i e urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në vendvotimet si në pjesën e II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura paneli e miratoi apelin e apeluesit si të bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze. Nga sa u tha më sipër e duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.882/2017 me datë 12.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.